



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:062803

Datë: 02.10.2020

Numri i dokumentit: 01160054

PKR.nr. 90-2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Zyhdi Haziri, me sekretaren juridike Naile Neziri, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh.A të cilin me autorizim e mbroj av. Sali Mekaj, nga Peja, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2. KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I. 64-2020 e dates 12.03.2020, të cilën e përfaqësonte prokurori Arben Kadriu pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 21.09.2020 mori dhe publikisht shpalli këtë :

AKT GJYKIM

I akuzuari Sh.A, me pseodonim Ll., nga i ati Xh. dhe nëna R. e gjinisë K., i lindur me datë ... në Pejë ku edhe jejtun, me nr. personal ..., i martuar, prind i dy fëmijëve, i punësuar si postjer tani i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme teknologji ushimore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. së Kosovës. Edhe më parë i denuar.

ËSHTË FAJTOR

-I-

I pandehuri: Sh. A.

Sepse me datë 03. Qeroshr 2020 rethë orës 21,00 min, në Gjilan pas marrëveshjes paraprake me të pandehurin D.A nga Gjilani, për shitje të substancës narkotike, e cila me ligj është shpallur si substancë e rrezikshme, nga Peja janë sisur i pandehuri Sh.A, me veturën VW “Passat” me targa ..., ngjyrë e zezë, të cilin e ka shoqëruar i pandehuri F. O, të përcjellur nga i pandehuri F. R, me veturën “Polo Supo” ashtu që në Gjilan, janë ndalur nga Policia e Kosovës dhe gjatë kontrollës së veturs VW “Passat” në pjesën e përpame në anën e djathtë nën tepi është gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike e llojit “Marihuanë, në peshë prej 490.21 gram dhe të pandehurit janë arrestuar.

- me çka ka kryer veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2, KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 7, 8, 38,39,40, 42, 43, 69, 70, 71, 79, dhe 267 par.5. të KPRK-ës si dhe nenit 365, dhe 451 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM DHE GJOBË

Ashtu që të akuzuarit Sh.A për dispozitivin nën I.të akuzës i shqiptohet denim me burgim prej 12. (dymbdhjet muaj) muaj si dhe denim me gjobë në shumë prej 500 euro,

Të akuzuarit në denimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 03.qershor 2020 deri me date 21.09.2020.

Të akuzuarit I shqiptohet edhe denimi plotësues kunfiksimi I sasisë narkotike të llojit “Marihuan” në peshë prej 498,21 gram si dhe ti konfiskohet edhe automjeti I tipit “Passat” me regjistrim 03-208-FS të përdorur ditën kritike.

Obligohet I akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, poashtu në emër të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP.I.nr. 64/2020 të date 02.09.2020 ndaj të akuzuarëve Sh.A, nga Peja, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautoruar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2. të KPRK-ës.

Në shqyrtimi fillestar të dates 22.06.2020 kryetari I trupit gjykues me aktvendim ka veçu procedure ndaj të të akuzuarëve F.O, F.R për shkak të veprës penale blerja posedimi I paautorizuar I narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 2. lidhur 33 par.1. të KPRK-ës dhe D. A, për shkak të veprës penale blerja posedimi I paautorizuar I narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par. 2. lidhur me nenin 28 të KPRK-ës ngase të njejtit nuk e kanë pranuar fajësinë, ndërsa I akuzuari Sh.A e ka pranuar veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja ee paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2. të KPRK-ës.

Në seancën fillestare të datës 21.09.2020, i akuzuari Sh.A j, pas konsultimit me mbrojtësen e tij me autorizim av. Sali Mekaj nga Peja, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori I shtetit Arben Kadriu, në fjalës përfundimtare ka deklaruar se gjatë procedurës paraprake dhe gjatë hetimeve e edhe sot në shqyrtimin fillestar I pandehuri e ka pranuar fajësinë duke ju bindur provave materiale andaj I propozoj kryetarit të trupit gjykues që

të njejtin ta shpalli fajtor dhe ti shqiptoj një denim meritor sipas ligjit duke rrespektuar dhe matjen e denimit ndaj të njejtin ngase I pandehuri në çdo faze të procedurës ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes.

Mbrojtësi I të akuzuarit Sh.A, av. Sali Mekaj, gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se në çdo faze të procedurës I mbrojturi im e ka pranuar fajësinë dhe ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes dhe gjatë kohës së pandemisë kemi bërë iniciimin në prokurori për lidhjen e marveshjes mbi pranimin e fajësisë për këtë çështje juridiko – penale, dhe në seancën e sotme të shqyrtimit fillestar I njejtin ka pranuar fajësinë dhe është pënduar për veprimet e bëra, andaj propozoj kryetarit të trupit gjykues që ti merr si rrethana lehtësuese ndaj sanksionit penal edhe atë se I pandehuri është I moshës së re, është prind I dy fëmijëve, kujdestar I familjes dhe si rrethanë veqanarisht lehtësuese pranimi I fajësisë për këtë veprë penale e cila I vëhet në barrë dhe konsideroj se edhe me një denim më të but do të arrihet qëllimi I denimit.

I pandehuri Sh.A në fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrahu fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe ndiej keqardhje për kryerjen e kësaj veprë penale dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

2. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar i akuzuari Sh.A, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën e lartëcekur dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale. Kryetari i trupit gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, I akuzuari nuk është i shtrenguar nga askush për pranimin e veprës penale, pranimin e fajësisë e ka bërë pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat e çështjes që përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të çartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar dhe vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit

Duke u bazuar në këto që u ceken më lart, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike : se i akuzuari Sh.A, me dashje e ka kryer veprën penale dhe poa autorizim ka blerë, poseduar, shpërndar dhe shitur pa autorizuar substancën narkotike dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 2, KPRK-ës, dhe i njejtin ka transportuar pa autorizim përmes trafikut duke bartur nga një vend në vendin tjetër, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit. Si rezultat i kësaj gjendje të vërtetuar faktike, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që ta shpallë fajtor të akuzuarin Sh.A, për kryerjen e veprës penale të lartcekura, ngase ka ardhur në përfundim se veprimet e tij i përmbajnë të gjitha elementet e kësaj veprë penale dhe se për të njejtin është penalisht përgjegjës.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 267 par. 2 . të KPRK-së, kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton , dorëzon, dërgon ose dërgon në transit substance apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë,

substanca psikotrope ose substance analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shiitje denohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbdhjetë (12) vite.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69, 70 dhe 71, të KPRK-së. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese, mbi bazën e të cilës kryetari i trupit gjykues i ka shqiptuar dënim për veprat penale si më lartë, është fakt se I pandehuri i ka pranuar fajësinë për veprën penale gjatë shqyrtimit fillestar dhe këtë e kishte bërë edhe gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Kjo është një rrethanë veqanarisht lehtësuese e duke u ndërlidhur edhe me rrethanat tjera, tregon se edhe me një dënim më të but mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

Përveq faktit se i akuzuari e ka pranuar fajësinë si rrethanë tjetër lehtësuese kryetari i trupit gjykues ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se është pendu për kryerjen e këtyre veprave penale dhe në seancën e shqyrtimit fillestar, se i pandehuri është i moshës reaktivisht të re, sjellja e tij e mirë gjatë shqyrtimit fillestar, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër tjetër penale, është mbajtës i familjes, andaj Gjykata duke i marrë për bazë të gjitha këto të cekura më lartë ka vlerësuar se me rastin konkret ekzistojnë rrethana me të cilat tregojnë se edhe me një dënim më të but mund të arrihet qëllimi i dënimit. Ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë kryetari i trupit gjykues ka marrë për bazë edhe gjendjen ekonomike të të akuzuarit se i njëjti është i pa punësuar, dhe se poqese të njëjtit do ti shqiptohet një dënim më i lartë to ta vështëroj gjendjen ekonomike e tij dhe familjes së tij.

6. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit Sh.A, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Me rastin e shqiptimit të dënimit me burg dhe me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të akuzuarit.

Gjykata për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par. 2. të KPRK ka shqiptuar dënimin nën minimum sipas dispozitave ligjore me arsyetim se i njëjti e ka pranuar fajësinë për këtë vepër penale e cila I vëhet në barrë, dhe është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale duke e shpallur fajtor me dënim me burg dhe me gjobë dhe konform dispozitave ligjore të KPRK-së.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerjen e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë

personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me llogaritjen e paraburgimit në denimin e shqiptuar.

Kryetari i trupit gjykues duke aplikuar nenin 79 të KPRK ka vendosur që të akuzuarit Sh.A koha e kaluar në paraburgim nga data 03. Qershor e deri 21.09.2020 në denimin e shqiptuar me burgim ashtu që një ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet një ditë të denimit me burgim.

8. Vendimi mbi denimin plotësues.

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 267 par.5. të KPRK ka vendosur që ndaj të pandehurit përveq denimit kryesor ti shqiptoj edhe denimin plotësues marrja – konfiskimin e sendit edhe atë sasinë narkotike në shumë prej 498,21 gram të llojit “Marihuanë” si dhe automjetin e tipit “Passat” me targa të regjistrimit..., e cila narkotikë është mshfehur në automjet dhe është përdurur ditën kritike për kryerjen e veprës penale duke transportuar sasinë narkotike me të njejtin automjet i cili mjet është rezultat i kryerjes së kësaj vepre penale.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues duke u bazuar nenin 451 paragrafi 1 të KPPK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumë prej 50, (pesëdhjet) euro, shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe të paguaj 50 euro në emër të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Krimeve të Rënda
Pkr. 90-2020 Më 21. shtator 2020

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Zyhdi Haziri

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.